

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: MARRËVESHJES KUADËR: “Blerje Artikuj ushqimorë ndarë në 5 (pesë) lote” si më poshtë:

- Loti I. “Blerje bukë gruri dhe simite”
- Loti II “Blerje bulmet dhe vezë”
- Loti III. “Blerje mish,nënproduktet e tij dhe peshk”
- Loti IV. “Blerje ushqime koloniale”
- Loti V. “Blerje fruta perime”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 03221210-1, 03211300-6,15811100 - 7,03222321-9 , 15110000-2 , 15511000-3, 15542000-9 03311000-2

VLERA E FONDIT LIMIT: 44,090,884 (dyzet e katër milion e nëntëdhjetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e katër) **Lekë pa TVSH** ose 441,526.98 (katërqind e dyzet e një mijë e pesëqind e njëzet e gjashtë pikë nëntëdhjetë e tetë) EURO pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë date 13.08.2024 është 99.86 lekë.

- **Loti I. “Blerje bukë gruri dhe simite”** me fond limit të marrëveshjes kuadër: **3.155.400** (tre milion e njëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e katërqind) **lekë pa TVSH**, ose 31,598.24 (tridhjetë e një mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e tetë pikë njëzet e katër) EURO pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë date 13.08.2024 është 99.86 lekë.
- **Loti II. “Blerje Bulmet dhe Vezë”** me fond limit të marrëveshjes kuadër: **10,759,542** (dhjetë milion e shtatëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e dyzet e dy) **lekë pa TVSH** ose 107,746.26 (njëqind e shtatë mijë e shtatëqind e dyzet e gjashtë pikë njëzet e gjashtë) EURO pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë date 13.08.2024 është 99.86 lekë.
- **Loti III. “Blerje Mish, nënproduktet e tij dhe peshk”**, me fond limit të marrëveshjes kuadër: **11,364,834** (njëmbëdhjetë milion e treqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e tetëqind e tridhjetë e katër) **lekë pa TVSH**, ose 113,807.67 (njëqind e trembëdhjetë mijë e tetëqind e shtatë pikë gjashtëdhjetë e shtatë) EURO pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë date 13.08.2024 është 99.86 lekë.
- **Loti IV. “Blerje Ushqime Koloniale”**, me fond limit të marrëveshjes kuadër: **12,225,690** (dymbëdhjetë milion e dyqind e njëzet e pesë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë) **lekë pa TVSH**

ose 122,428.30 (njëqind e njëzet e dy mijë e katërqind e njëzet e tetë pikë tridhjetë) EURO pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë date 13.08.2024 është 99.86 lekë.

- **Loti V. “Blerje Fruta Perime”**, me fond limit të marrëveshjes kuadër **6,585,418** (gjashtë milion e pesëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e katërqind e tetëmbëdhjetë) **lekë pa TVSH** ose 65,946.51 (gjashtëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e dyzet e gjashtë pikë pesëdhjetë e një) EURO pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë date 13.08.2024 është 99.86 lekë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar) nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti/Enti Kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara në rolin e organit qëndror blerës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Shtojca 7

LOTI 1 “BLERJE BUKË GRURI DHE SIMITE ”

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dhe nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë, **Licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”(e vlefshme)** të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik, sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar nenit 40, pika 5 , gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar; Ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë; VKM nr.538, date 26.05.2009 ”Per licencat dhe lejet qe trajtohen nga apo nepermjet Qendres Kombetarre te Licencimit (QKL) dhe disa rregullime te tjera nenligjore te perbashketa” te ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për kryerjen e furnizimit objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Operatorët Ekonomik duhet të zbatojnë kërkesat e Ligjit Nr.9863 datë 28.01.2008 “Për ushqimin” i ndryshuar, për furnizimin/shpërndarjen me produktet ushqimore në ambientet e përcaktuara, si dhe për ruajtjen e higjenes dhe mjediset, kushteve tekniko-teknologjike dhe personelit.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e fondit limit të lotit të parë**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur në mbështetje të nenit 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 42 pika 3, nenit 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”te ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosija e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të këtij loti është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 42 pika 3 ku përcaktohet se: “Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. **Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit**” dhe nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: c) 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar” duke qënë se vlera e fondit limit të lotit përkatës është nën vlerën e kufirit të ulët monetar dhe kriteri për secilin lot dhe konkretisht ai i përmbushjes së xhiros hartohet në përputhje me vlerën e vetë lotit dhe jo vlerës totale të procedurës.

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit për lotin e parë është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur të thjeshtuar” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi sipas përcaktimit të bërë në nenin 42 pika 3 e VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

2.3 Kapaciteti teknik

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 20 % e vlerës së fondit limit të këtij loti**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nën 42/3 dhe nën 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit të këtij loti. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 42 pika 3 e VKM nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) duke qënë se vlera e fondit limit të këtij loti është brenda kufirit monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **një deklaratë**, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit** të artikujve objekt prokurimi në adresat e përcaktuara nga autoritetet kontraktore përfituese.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët të sigurojnë autoritetin kontraktor se transporti i mallit do të realizohet në kohë dhe në vendet e caktuara nga Autoriteti Kontraktor përfitues.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë **të paktën 1 (një)** automjet ATP (jo frigorifer), për transportin e mallrave, i cili mund të jetë në pronësi/qera/huapërdorje.

Për sa me sipër operatori ekonomik të vetedeklarojë sipas formatit të mëposhtem:

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Kapaciteti mbajtes	Statusi
1				pronësi /qera/huapërdorje.

- Për mjetet në pronësi të paraqitet dokumentacioni si më poshtë vijon:

1. Çertifikatën e pronësisë,
2. Lejen e qarkullimit të mjetit,
3. Çertifikatën e kontrollit teknik (të vlefshëm)
4. Sigurimin e detyrueshëm të mjeteve (të vlefshëm)

- Për mjetet me status qera/huapërdorje të paraqitet dokumentacioni si më poshtë vijon:

1. Kontratën e qerasë/huapërdorjes (e vlefshme)
2. Lejen e qarkullimit të mjetit
3. Çertifikatën e kontrollit teknik (të vlefshëm)
4. Sigurimin e detyrueshëm të mjeteve (të vlefshëm).

Shënim: Kriteri nr.2.3.3 do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetedëklarimit shtojca 8. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori ekonomik kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, Autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet për mjetet që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit sipas afatit të lëvrimit. Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar një minimum të mjeteve që operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion për zbatimin e kontratës, brenda marrëveshjes kuadër duke marrë parasysh sasinë e mallit objekt prokurimi, pozicionin gjeografik të autoritetit kontraktor përfitues.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 2 (dy) punonjës, për të realizuar shërbimin e transportit dhe shpërndarjen e mallrave objekt prokurimi, në destinacion, si më poshtë:

Stafi	Nr.
Shofer	1
Punetorë të thjeshtë	1

Total	2
-------	---

- Per punonjësin e punësuar shofer të paraqitet kontrate pune (e vlefshme) dhe leje përkatëse të drejtimit të mjetit (e vlefshme)
- Për punonjësin e punësuar punëtor i thjeshtë të paraqitet vetem kontratë pune (e vlefshme).

Shenim:

Në lidhje me kërkesën që OE të disponojë 1 (një) person me profesion shofer, OE paraqet në staf 1 (një) punonjës, i cili jo domosdoshmërisht është i regjistruar në listëpagesat e shoqërisë si shofer, por që disponon lejen e drejtimit përkatëse dhe mund të realizojë me sukses shërbimin e transportit të artikujve ushqimore, brenda afateve të ekzekutimit të kontratës.

Shenim: *Kriteri Nr.2.3.4 do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetedëklarimit shtojca 8. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori ekonomik kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Numri minimal prej 2 punonjësish, përkatësisht shofer/punëtor i thjeshtë, që operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion, është kërkuar duke u bazuar në numrin e automjeteve që janë kërkuar për kryerjen e transportit të mallrave objekt prokurimi sasisë së mallrave që do të transportohen dhe shpërndahen në destinacionin e kërkuar nga autoriteti kontraktor përfitues. Në lidhje me kërkesën që OE të disponojë 1 (një) person me profesionin shofer/punëtor i thjeshtë, OE paraqet 1 (një) punonjës që mund të jetë regjistruar në listëpagesat e shoqërisë si shofer ose punonjës i thjeshtë, por që disponon lejen përkatëse të drejtimit të mjetit dhe mund të realizojë me sukses shërbimin e transportit të mallrave objekt prokurimi brenda afateve të ekzekutimit të kontratës.*

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës duhet të vetëdeklarojë se, nga kontrolli i fundit i ushtruar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

Shenim: *Kriteri Nr 2.3.5 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e deklaratës. Dokumenti i kërkuar më sipër do të paraqitet në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

Argumentimi: *Në bazë të nenit 40, pika 6 dhe 8, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar dhe rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018 nisur nga objekti i prokurimit, furnizime me ushqime, është e rëndësishme që operatorët ekonomikë të jenë të vlerësuar nga organet kompetente që e ushtrjnë aktivitetin e tyre konform legjislacionit të fushës, kjo për të rritur dhe garantuar sigurinë ushqimore dhe për të mbrojtur konsumatorin e fundit.*

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht 1 (një) stabiliment, në zbatim të nenit 19 të ligjit nr. 9863, date 28.01.2008 “Për ushqimin” (i ndryshuar).

Për të provuar këtë kriter duhet të paraqesë dokumentet:

- a) Çertifikatë pronësie ose kontratë noteriale qeraje/përdorimi të vlefshme, për stabilimentin.

- b) Licencen e kategorisë “II.1.A.1 për stabilimentin që ka paraqitur dokumentet sipas gjurmës “a” të këtij kriteri.

Në rast të konstatimit të ushtrimit të stabilimentit jo në përputhje me këtë nen do të referohen pranë AKU për ndjekjen e procedurave përkatëse administrative sipas nenit 68 të ligjit nr. 9863, date 28.01.2008 “Per ushqimin” i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenit 40, pika 8 e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar; Ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë; VKM nr.538, date 26.05.2009 ”Per licencat dhe lejet qe trajtohen nga apo nepermjet Qendres Kombetarre te Licencimit (QKL) dhe disa rregullime te tjera nenligjore te perbashketa” të ndryshuar; nenit 19 të ligjit nr. 9863, date 28.01.2008 “Per ushqimin” Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë ambientet/stabilimentet dhe licencat perkatëse per keto stabilimente, për kryerjen e furnizimit objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Operatorët Ekonomikë duhet të zbatojnë kërkesat e Ligjit Nr.9863 datë 28.01.2008 “Për ushqimin” i ndryshuar, për furnizimin/shpërndarjen me produktet ushqimore në ambientet e përcaktuara, si dhe për ruajtjen e higjenes dhe mjediset, kushteve tekniko-teknologjike dhe personelit. Dhënia e lejes përkatëse për fillimin e veprimtarisë së stabilimentit bëhet kur plotësohen kërkesat tekniko-teknologjike, higjieno-sanitare dhe veterinarë për të garantuar sigurinë dhe cilësinë e ushqimeve, në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi, për të mbrojtur shëndetin e konsumatorit. Qënësia e kësaj license garanton AK se operatori ekonomik lidhur me stabilimentin që disponon në njërin nga format e sipërcituara ka përmbushur të gjithë parametrat e kërkuar dhe si rrjedhojë është pajisur me këtë lloj license për stabilimentin..Kërkesa për minimalisht 1(një) stabiliment është një kërkesë minimale qe i krijon siguri autoritetit kontraktor se operatori ekonomik ka jo vetem pajisjet por edhe ambientet e pershtatshme për realizimin me sukses dhe në vazhdimesi të kontratës objekt prokurimi.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të deklarojë sipas tabelës 1 nëse është **prodhues**. Nëse operatori ekonomik është **tregtues** duhet të deklarojë sipas tabelës 2, kontratat e furnizimit të lidhura me prodhuesin ose distributorin e autorizuar nga prodhuesi, për artikujt objekt prokurimi.

- o **Tabela 1.** Forma e deklaramit për operatorin ekonomik që paraqitet si prodhues i mallit.

Nr.	Emertimi i artikullit	Prodhues. Të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website
1		
2		
Etj...		

- o **Tabela 2.** Forma e deklaramit për operatorin ekonomik që paraqitet si tregtues i autorizuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi.

Nr.	Emertimi i artikullit	Prodhuesi/Distributori i autorizuar Të dhëna të plota si: telefon, fax, e-mail, website	Data e fillimit të kontratës se furnizimit	Data e perfundimit të kontratës se furnizimit
1				
2				
Etj...				

Shenim: Kriteri nr.2.3.7 konsiderohet i permbyshur me plotesimin e vetëdeklarimit, sipas tabelës së mësipërme. Kontratat e furnizimit të kerkuara me siper do te paraqiten ne rast se operatori kualifikohet i pari, por perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit ose nese kerkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të nenit 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar autoriteti kontraktor ka të drejtë të kërkojë edhe dokumenta të tjera të cilat i konsideron të rëndësishme për objektin. Duke qënë se kemi të bëjmë me furnizime me ushqime, kërkohet siguri se operatori ekonomik ka mundësi të furnizojë në mënyrë të vazhdueshme dhe sipas kërkesës dhe afatit të caktuar nga autoriteti kontraktor, si në rastin kur është prodhues ashtu edhe në rastin kur nuk është prodhues i produktit. Duke qënë se kryesisht Autoritetet kontraktore përfutuese janë spitale, qender pritje per të moshuar apo shtëpi foshnje edhe nevoja për ushqim është në çdo kohë domosdoshmëri, lind e nevojshme që të garantohet AK dhe të krijojë bindjen se furnizimi i ushqimit do të jetë i pandërprerë për të mos krijuar impakt tek konsumatori. Kontratat e furnizimit sigurojnë AK që tregtari ka një marrëveshje të qëndrueshme me prodhuesin, duke minimizuar rrezikun e ndërprerjeve në furnizim gjithashtu janë tregues edhe për një marrëdhënie të qëndrueshme me prodhuesin dhe ky fakt mund të ndihmojë në garantimin e cilësisë së produktit, pasi prodhuesi është i angazhuar për të permbyshur standardet e kerkuara.

2.3.8 Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë në procedurën e prokurimit publik çertifikatën **SSH EN ISO 22000:2018** ose ekuivalente për sistemin e menaxhimit të sigurisë ushqimore për prodhimin dhe tregtimin e produkteve ushqimore me origjinë shtazore dhe jo shtazore, të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në Rekomandim Nr. 10181 Prot, datë 19.11.2018, “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore” të hartuar nga Agjencia e Prokurimit Publik në bashkëpunim me Autoritetin Kombëtar të Ushqimit. Kriteri për Certifikatë të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë SSH EN ISO 22000:2018, është vendosur në bazë të nenit 79 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 44, të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion certifikimet e duhura për mallrat objekt prokurimi.

3-Standarti ISO 22000 specifikon, kërkesat e përgjithshme për zhvillimin, zbatimin dhe përmirësimin e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore të një kompanie. ISO 22000 u drejtohet të gjitha

kompanive që marrin pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në zinxhirin e furnizimit ushqimor dhe mund të zbatohet nga të gjitha kompanitë, pavarësisht nga madhësia apo kompleksiteti i tyre.

ISO 22000 është standardi më i lartë i certifikimit të Sistemeve të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore. Parimet themelore të standardit janë:

- Kontroll efektiv në të gjithë zinxhirin e furnizimit ushqimor
- Komunikim efektiv midis të gjitha palëve të interesuara të zinxhirit të furnizimit ushqimor (biznese, furnitorë, klientë, autoritete)
- Menaxhim sistematik
- Programet e nevojshme
- Parimet e analizës së rrezikut dhe pikat kritike të kontrollit (HACCP)

Standardi bazohet gjithashtu në parimet që janë të përbashkëta me standardet e sistemit të menaxhimit. Parimet e menaxhimit janë:

- Fokus ndaj klientit
- Angazhimi i menaxhimit të lartë
- Pjesëmarrje aktive e personelit
- Qasje ndaj procesit
- Përmirësim i vazhdueshëm
- Vendimmarrje e bazuar në dokumentacion
- Menaxhim i marrëdhënieve me palët e interesuara

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shënim: Operatori ekonomik i cili oferton në më shumë se sa një Lot, duhet të ketë/disponojë kapacitetin ekonomik – financiar (pika 2.2.1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetin teknik pika 2.3.1 e seksionit 2.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku.

Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotësohet për kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike sipas përcaktimit më sipër për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të s'kualifikohet nga të gjitha Lotet ku ka ofertuar.

Shtojca 7 LOTI 2 “BLERJE BULMET DHE VEZË”

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë **Licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”** dhe **Licencë të kategorisë “II.1.B - Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)”**, të lëshuara nga Qendra Kombëtare e Biznesit (nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik, sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018). Per kete arsye detyrimisht Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet te jete i licensuar sipas dispozitave perkatese ligjore dhe nen ligjore).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar nenit 40, pika 5 , gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar; Ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë; VKM nr.538, date 26.05.2009 ”Per licencat dhe lejet qe trajtohen nga apo nepermjet Qendres Kombetarre te Licencimit (QKL) dhe disa rregullime te tjera nenligjore te perbashketa” te ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për kryerjen e furnizimit objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Operatorët Ekonomik duhet të zbatojnë kërkesat e Ligjit Nr.9863 datë 28.01.2008 “Për ushqimin” i ndryshuar, për furnizimin/shpërndarjen me produktet ushqimore në ambientet e përcaktuara, si dhe për ruajtjen e higjienës dhe mjediset, kushteve tekniko-teknologjike dhe personelit.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit të lotit të dytë**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur në mbështetje të nenit 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 42 pika 3, nenit 43 pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “ Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit të këtij loti është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 42 pika 3 ku përcaktohet se: “Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. **Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit**” dhe nenin 43 pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e përllëgaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar” duke qënë se vlera e fondit limit të lotit përkatës midis kufirit të ulët monetar dhe kufirit të lartë monetar dhe kriteri për secilin lot dhe konkretisht ai i përmbushjes së xhiros hartohet në përputhje me vlerën e vetë lotit dhe jo vlerës totale të procedurës.

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit për lotin e dytë është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi sipas përcaktimit të bërë në nenin 42 pika 3 e VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se:

.....*Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin emnistrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.*”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilnaceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 40 % e vlerës së fondit limit të këtij loti**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenit 40 pika 4 dhe nenit 42/3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit të këtij loti. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 42 pika 3 e VKM nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) duke qënë se vlera e fondit limit të këtij loti është brenda kufirit monetar që zhvillohet procedura e hapur mbi kufirin e lartë monetar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.*

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqes **një deklaratë**, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit për artikujt objekt prokurimi** në adresat e përcaktuara nga autoritetet kontraktore përfituese.

***Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët të sigurojnë autoritetin kontraktor se transporti i mallit do të realizohet në kohën e duhur dhe në vendet e caktuara nga Autoriteti Kontraktor përfitues.*

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë të paktën 1 (një) automjet ATV (frigorifer), për transportin e mallrave, të cilin duhet ta ketë në pronësi /qera/huapërdorje.

Për sa me sipër operatori ekonomik të vetedeklarojë sipas formatit të mëposhtem:

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Kapaciteti mbajtes	Statusi
1				pronësi /qera/huapërdorje.

- Për mjetet në pronësi të paraqitet dokumentacioni si më poshtë vijon:

1. Çertifikata e pronësise,
2. Leje qarkullimi të mjetit,
3. Çertifikatën e kontrollit teknik (të vlefshëm)
4. Sigurimin e detyrueshëm të mjeteve (të vlefshëm)

- Për mjetet me status qera/huapërdorje të paraqitet dokumentacioni si më poshtë vijon:

1. Kontrata e qerasë/huapërdorjes (e vlefshme)
2. Leje qarkullimi të mjetit
3. Çertifikatën e kontrollit teknik (të vlefshëm)
4. Sigurimin e detyrueshëm të mjeteve (të vlefshëm).

Shënim: Kriteri Nr.2.3.3 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetedeklarimit shtojca 8. Dokumentet e kerkuara me sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kerkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, Autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet për mjetet që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit sipas afatit të lëvrimit. Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar një minimum të mjeteve që operatorit ekonomik duhet të ketë në dispozicion për zbatimin e kontratës, brenda marrëveshjes kuadër duke marrë parasysh sasinë e mallit objekt prokurimi, pozicionin gjeografik të autoritetit kontraktor përfitues.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 2 (dy) punonjës, për të realizuar shërbimin e transportit dhe shpërndarjen e mallrave objekt prokurimi në destinacion, si më poshtë:

Stafi	Nr.
Shofer	1
Punetorë të thjeshtë	1
Total	2

- Për punonjësin e punësuar shofer të paraqitet kontrate pune (e vlefshme) dhe leje përkatëse e drejtimit të mjetit (e vlefshme)
- Për punonjësin e punësuar punëtor i thjeshtë të paraqitet vetem kontratë pune (e vlefshme).

Shënim:

Në lidhje me kërkesën që OE të disponojë 1 (një) person me profesion shofer, OE paraqet në staf 1 (një) punonjës, i cili jo domosdoshmërisht është i regjistruar në listëpagesat e shoqërisë si shofer, por që disponon lejen përkatëse të drejtimit të mjetit dhe mund të realizojë me sukses shërbimin e transportit të artikujve objekt prokurimi, brenda afateve të ekzekutimit të kontratës.

Shënim: *Kriteri Nr.2.3.4 do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetedëklarimit shtojca 8. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori ekonomik kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Numri minimal prej 2 punonjësish, përkatësisht shofer/punëtor i thjeshtë, që operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion, është kërkuar duke u bazuar në numrin e automjeteve që janë kërkuar për kryerjen e transportit të mallrave objekt prokurimi sasisë së mallrave që do të transportohen dhe shpërndahen në destinacionin e kërkuar nga autoriteti kontraktor përfitues. Në lidhje me kërkesën që OE të disponojë 1 (një) person me profesionin shofer/punëtor i thjeshtë, OE paraqet 1 (një) punonjës që mund të jetë regjistruar në listëpagesat e shoqërisë si shofer ose punonjës i thjeshtë, por që disponon lejen përkatëse të drejtimit të mjetit dhe mund të realizojë me sukses shërbimin e transportit të mallrave objekt prokurimi brenda afateve të ekzekutimit të kontratës.*

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës duhet të vetdeklarojë se, nga kontrolli i fundit i ushtruar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

Shënim: *Kriteri nr.2.3.5 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e deklaratës. Dokumenti i kërkuar më sipër do të paraqitet në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

Argumentimi: *Në bazë të nenit 40, pika 6 dhe 8, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar dhe rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018. Nisur nga objekti i prokurimit, furnizime me ushqime, është e rëndësishme që operatorët ekonomikë të jenë të vlerësuar nga organet kompetente që e ushtrjnë aktivitetin e tyre konform legjislacionit të fushës, kjo për të rritur dhe garantuar sigurinë ushqimore dhe për të mbrojtur konsumatorin e fundit.*

e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilanca, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se:Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitetin sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 40 % e vlerës së fondit limit të këtij loti**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenit 40 pika 4 dhe nenit 42/3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit të këtij loti. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 42 pika 3 e VKM nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) duke qënë se vlera e fondit limit të këtij loti është brenda kufirit monetar që zhvillohet procedura e hapur mbi kufirin e lartë monetar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **një deklaratë**, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit** të artikujve objekt prokurimi në adresat e përcaktuara nga autoritetet kontraktore përfituese.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri

kërkohet që operatorët të sigurojnë autoritetin kontraktor se transporti i mallit do të realizohet në kohën e duhur dhe në vendet e caktuara nga Autoriteti Kontraktor përfitues.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë **të paktën 1 (një)** automjet ATP (jo frigorifer), për transportin e mallrave objekt prokurimi, të cilin duhet t'a ketë në pronësi /qera/huapërdorje.

Për sa me sipër operatori ekonomik te vetedeklaroje sipas formatit të mëposhtem:

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Kapaciteti mbajtes	Statusi
1				pronësi /qera/huapërdorje.

- Për mjetet në pronësi të paraqitet dokumentacioni si më poshtë vijon:

1. Çertifikata e pronësise,
2. Leje qarkullimi të mjetit,
3. Çertifikatën e kontrollit teknik (të vlefshëm)
4. Sigurimin e detyrueshëm të mjeteve (të vlefshëm)

- Për mjetet me status qera/huapërdorje të paraqitet dokumentacioni si më poshtë vijon:

1. Kontrata e qerasë/huapërdorjes (e vlefshme)
2. Leje qarkullimi të mjetit
3. Çertifikatën e kontrollit teknik (të vlefshëm)
4. Sigurimin e detyrueshëm të mjeteve (të vlefshëm).

Shenim: Kriteri nr.2.3.3 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 8. Dokumentet e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, Autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet për mjetet që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit sipas afatit të lëvrimit. Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar një minimum të mjeteve që operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion për zbatimin e kontratës, brenda marrëveshjes kuadër duke marrë parasysh sasinë e mallit objekt prokurimi, pozicionin gjeografik të autoritetit kontraktor përfitues.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 2 (dy) punonjës, për të realizuar shërbimin e transportit dhe shpërndarjen e mallrave objekt prokurimi, si më poshtë:

Stafi	Nr.
Shofer	1
Punetore te thjeshte	1
Total	2

- Për punonjësin e punësuar shofer të paraqitet kontratë pune (e vlefshme) dhe leje përkatëse e drejtimit të mjetit (e vlefshme)
- Për punonjësin e punësuar punëtor i thjeshtë të paraqitet vetëm kontratë pune (e vlefshme).

Shënim:

Në lidhje me kërkesën që OE të disponojë 1 (një) person me profesion shofer, OE paraqet në staf 1 (një) punonjës, i cili jo domosdoshmërisht është i regjistruar në listëpagesat e shoqërisë si shofer, por që disponon lejen përkatëse të drejtimit të mjetit dhe mund të realizojë me sukses shërbimin e transportit të artikujve objekt prokurimi brenda afateve të ekzekutimit të kontratës.

***Shënim:** Kriteri nr.2.3.4 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 8. Dokumentet e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Numri minimal prej 2 punonjësish, përkatësisht shofer/punëtor i thjeshtë, që operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion, është kërkuar duke u bazuar në numrin e automjeteve që janë kërkuar për kryerjen e transportit të mallrave objekt prokurimi sasisë së mallrave që do të transportohen dhe shpërndahen në destinacionin e kërkuar nga autoriteti kontraktor përfitues. Në lidhje me kërkesën që OE të disponojë 1 (një) person me profesionin shofer/punëtor i thjeshtë, OE paraqet 1 (një) punonjës që mund të jetë regjistruar në listëpagesat e shoqërisë si shofer ose punonjës i thjeshtë, por që disponon lejen përkatëse të drejtimit të mjetit dhe mund të realizojë me sukses shërbimin e transportit të mallrave objekt prokurimi brenda afateve të ekzekutimit të kontratës.*

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqese një deklaratë, me anë të së cilës duhet të vetdeklarojë se, nga kontrolli i fundit i ushtruar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

***Shënim:** Kriteri nr.2.3.5 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e deklaratës. Dokumenti i kërkuar më sipër do të paraqitet në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

***Argumentimi:** Në bazë të nenit 40, pika 6 dhe 8, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar dhe rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018. Nisur nga objekti i prokurimit, furnizime me ushqime, është e rëndësishme që operoret ekonomikë të jenë të vlerësuar nga organet kompetente që e ushtrjnë aktivitetin e tyre konform legjislacionit të fushës, kjo për të rritur dhe garantuar sigurinë ushqimore dhe për të mbrojtur konsumatorin e fundit .*

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht 1 (një) stabiliment, në zbatim të nenit 19 të ligjit nr. 9863, date 28.01.2008 “Për ushqimin”(i ndryshuar).

Për të provuar këtë kriter duhet të paraqesë dokumentet:

- a) Çertifikatë pronarie ose kontratë noteriale qeraje/përdorimi të vlefshme, për stabilimentin.
- b) Liçensen e kategorisë “II.1.A.1(e vlefshme), për stabilimentin që ka paraqitur dokumentet sipas gërmës “a” të këtij kriteri.

Në rast të konstatimit të ushtrimit të stabilimentit jo në përputhje me këtë nen do të referohen pranë AKU për ndjekjen e procedurave përkatëse administrative sipas nenit 68 të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenit 40, pika 8 e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar; Ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë; VKM nr.538, date 26.05.2009 ”Per licencat dhe lejet qe trajtohen nga apo nepermjet Qendres Kombetarre te Licencimit (QKL) dhe disa rregullime te tjera nenligjore te perbashketa” te ndryshuar; nenit 19 te ligjit nr. 9863, date 28.01.2008 “Per ushqimin”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë ambjentet/stabilimentet dhe licencat perkatese per keto stabilimente, për kryerjen e furnizimit objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Operatorët Ekonomikë duhet të zbatojnë kërkesat e Ligjit Nr.9863 datë 28.01.2008 “Për ushqimin” i ndryshuar, për furnizimin/shpërndarjen me produktet ushqimore në ambjentet e përcaktuara, si dhe për ruajtjen e higjienës dhe mjediset, kushteve tekniko-teknologjike dhe personelit. Dhënia e lejes përkatëse për fillimin e veprimtarisë së stabilimentit bëhet kur plotësohen kërkesat tekniko-teknologjike, higjiensanitare dhe veterinare për të garantuar sigurinë dhe cilësinë e ushqimeve, në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe të legjisllacionit në fuqi, për të mbrojtur shëndetin e konsumatorit. Qënësia e kësaj license garanton AK se operatori ekonomik lidhur me stabilimentin që disponon në njërën nga format e sipërcituara ka përbushur të gjithë parametrat e kërkuar dhe si rrjedhojë është pajisur me këtë lloj license për stabilimentin..Kërkesa për minimalisht 1(një) stabiliment është një kërkesë minimale qe i krijon siguri autoritetit kontraktor se operatori ekonomik ka jo vetem pajisjet por edhe ambjentet e përshtatshme për realizimin me sukses dhe në vazhdimësi të kontratës objekt prokurimi.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të deklarojë sipas tabelës 1 nëse është **prodhues**. Nëse operatori ekonomik është **tregtues** duhet të deklarohet sipas tabelës 2, kontratat e furnizimit të lidhura me prodhuesin ose distributorin e autorizuar nga prodhuesi, për artikujt objekt prokurimi.

○ **Tabela 1.** Forma e deklaramit për operatorin ekonomik që paraqitet si prodhues i mallit.

Nr.	Emertimi i artikullit	Prodhues. Të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website
1		
2		
Etj.,		

Tabela 2. Forma e deklaramit për operatorin ekonomik që paraqitet si tregtues i autorizuar nga prodhuesi ose distributor i autorizuar nga prodhuesi.

Nr.	Emertimi i artikullit	Prodhuesi/Distributori i autorizuar Të dhëna të plota të si: telefon, fax, e-mail, website	Data e fillimit të kontratës se furnizimit	Data e perfundimit te kontratës se furnizimit
1				

2			
Etj.,			

Shenim: Kriteri nr.2.3.7 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e vetëdeklarimit, sipas tabelës së mësipërme. Kontratat e furnizimit të kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të nenit 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar autoriteti kontraktor ka të drejtë të kërkojë edhe dokumenta të tjera të cilat i konsideron të rëndësishme për objektin. Duke qënë se kemi të bëjmë me furnizime me ushqime, kërkohet siguri se operatori ekonomik ka mundësi të furnizojë në mënyrë të vazhdueshme dhe sipas kërkesës dhe afatit të caktuar nga autoriteti kontraktor, si në rastin kur është prodhues ashtu edhe në rastin kur nuk është prodhues i produktit. Duke qënë se kryesisht Autoritetet kontraktore përfituese janë spitale, qender pritje për të moshuar apo shtëpi foshnje edhe nevoja për ushqim është në çdo kohë domosdoshmëri, lind e nevojshme që të garantohet AK dhe të krijojë bindjen se furnizimi i ushqimit do të jetë i pandërprerë për të mos krijuar impakt tek konsumatori. Kontratat e furnizimit sigurojnë AK që tregtari ka një marrëveshje të qëndrueshme me prodhuesin, duke minimizuar rrezikun e ndërprerjeve në furnizim gjithashtu janë tregues edhe për një marrëdhënie të qëndrueshme me prodhuesin dhe ky fakt mund të ndihmojë në garantimin e cilësisë së produktit, pasi prodhuesi është i angazhuar për të përmbushur standardet e kërkuara.

2.3.8 Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë në procedurën e prokurimit publik certifikatën **SSH EN ISO 22000:2018** ose ekuivalente për sistemin e menaxhimit të sigurisë ushqimore për prodhimin dhe tregtimin e produkteve ushqimore me origjinë shtazore dhe jo shtazore, të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në Rekomandim Nr. 10181 Prot, datë 19.11.2018, “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore” të hartuar nga Agjencia e Prokurimit Publik në bashkëpunim me Autoritetin Kombëtar të Ushqimit. Kriteri për Certifikatë të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë ISO 22000:2018, është vendosur në bazë të nenit 79 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 44, të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion certifikimet e duhura për mallrat objekt prokurimi.

-Standarti ISO 22000 specifikon, kërkesat e përgjithshme për zhvillimin, zbatimin dhe përmirësimin e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore të një kompanie. ISO 22000 u drejtohet të gjitha kompanive që marrin pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në zinxhirin e furnizimit ushqimor dhe mund të zbatohet nga të gjitha kompanitë, pavarësisht nga madhësia apo kompleksiteti i tyre.

ISO 22000 është standardi më i lartë i certifikimit të Sistemeve të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore. Parimet themelore të standardit janë:

- Kontroll efektiv në të gjithë zinxhirin e furnizimit ushqimor
- Komunikim efektiv midis të gjitha palëve të interesuara të zinxhirit të furnizimit ushqimor (biznese, furnitorë, klientë, autoritete)

- Menaxhim sistematik
- Programet e nevojshme
- Parimet e analizës së rrezikut dhe pikat kritike të kontrollit (HACCP)

Standardi bazohet gjithashtu në parimet që janë të përbashkëta me standardet e sistemit të menaxhimit. Parimet e menaxhimit janë:

- Fokus ndaj klientit
- Angazhimi i menaxhimit të lartë
- Pjesëmarrje aktive e personelit
- Qasje ndaj procesit
- Përmirësim i vazhdueshëm
- Vendimmarrje e bazuar në dokumentacion
- Menaxhim i marrëdhënieve me palët e interesuara

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

***Shënim:** Operatori ekonomik i cili oferton në më shumë se sa një Lot, duhet të ketë/disponojë kapacitetin ekonomik – financiar (pika 2.2.1 dhe 2.2.2 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetin teknik pika 2.3.1 e seksionit 2.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku.*

Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotësohet për kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike sipas përcaktimit më sipër për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të s'kualifikohet nga të gjitha Lotet ku ka ofertuar.

Shtojca 7

LOTI 5 “BLERJE FRUTA-PERIME ”

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për

Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë, **Licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”(e vlefshme)** të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik, sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018).

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar nenit 40, pika 5 , gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar; Ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë; VKM nr.538, date 26.05.2009 ”Per licencat dhe lejet qe trajtohen nga apo nepermjet Qendres Kombetarre te Licencimit (QKL) dhe disa rregullime te tjera nenligjore te perbashketa” te ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për kryerjen e furnizimit objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Operatorët Ekonomik duhet të zbatojnë kërkesat e Ligjit Nr.9863 datë 28.01.2008 “Për ushqimin” i ndryshuar, për furnizimin/shpërndarjen me produktet ushqimore në ambientet e përcaktuara, si dhe për ruajtjen e higjenes dhe mjediset, kushteve tekniko-teknologjike dhe personelit.*

2.3 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e fondit limit të lotit të pestë**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është vendosur në mbështetje të nenit 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 42 pika 3, nenit 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”te ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023“Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “ Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit te këtij loti është brenda kufirit të përcaktuar ne nenin 42 pika 3 ku përcaktohet se: “Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë

kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. **Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit**” dhe nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar, ku përcaktohet se “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar” duke qënë se vlera e fondit limit të lotit përkatës është nën vlerën e kufirit të ulët monetar dhe kriteri për secilin lot dhe konkretisht ai i përmbushjes së xhiros hartohet në përputhje me vlerën e vetë lotit dhe jo vlerës totale të procedurës.

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit për lotin pestë është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur të thjeshtuar ” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi sipas përcaktimit të bërë në nenin 42 pika 3 e VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

2.3 Kapaciteti teknik

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 20 % e vlerës së fondit limit të këtij loti**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- c) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- d) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenit 42/3 dhe nenit 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit të këtij loti. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 42 pika 3 e VKM nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) duke qënë se vlera e fondit limit të këtij loti është brenda kufirit monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **një deklaratë**, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit** të artikujve objekt prokurimi në adresat e përcaktuara nga autoritetet kontraktore përfituese.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët të sigurojnë autoritetin kontraktor se transporti i mallit do të realizohet në kohë dhe në vendet e caktuara nga Autoriteti Kontraktor përfitues.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë të paktën 1 (një) automjet ATP (jo frigorifer), për transportin e mallrave, i cili mund të jetë në pronësi/qera/huapërdorje.

Për sa me siper operatori ekonomik te vetedeklaroje sipas formatit te meposhtem:

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Kapaciteti mbajtes	Statusi
1				pronësi /qera/huapërdorje.

- Për mjetet në pronësi të paraqitet dokumentacioni si më poshtë vijon:

1. Çertifikatën e pronësisë,
2. Lejen e qarkullimit të mjetit,
3. Çertifikatën e kontrollit teknik (të vlefshëm)
4. Sigurimin e detyrueshëm të mjeteve (të vlefshëm)

- Për mjetet me status qera/huapërdorje të paraqitet dokumentacioni si më poshtë vijon:

1. Kontratën e qerasë/huapërdorjes (e vlefshme)
2. Lejen e qarkullimit të mjetit
3. Çertifikatën e kontrollit teknik (të vlefshëm)
4. Sigurimin e detyrueshëm të mjeteve (të vlefshëm).

Shënim: Kriteri nr.2.3.3 do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetedëklarimit shtojca 8. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori ekonomik kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohe sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, Autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet për mjetet që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit sipas afatit të lëvrimit. Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar një minimum të mjeteve që operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion për zbatimin e kontratës, brenda marrëveshjes kuadër duke marrë parasysh sasinë e mallit objekt prokurimi, pozicionin gjeografik të autoritetit kontraktor përfitues.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 2 (dy) punonjës, për të realizuar shërbimin e transportit dhe shpërndarjen e mallrave objekt prokurimi, në destinacion, si më poshtë:

Stafi	Nr.
Shofer	1
Punetorë të thjeshtë	1
Total	2

- Për punonjësin e punësuar shofer të paraqitet kontrate pune (e vlefshme) dhe leje përkatëse të drejtimit të mjetit (e vlefshme)

- Për punonjësin e punësuar punëtor i thjeshtë të paraqitet vetem kontratë pune (e vlefshme).

Shenim:

Në lidhje me kërkesën që OE të disponojë 1 (një) person me profesion shofer, OE paraqet në staf 1 (një) punonjës, i cili jo domosdoshmërisht është i regjistruar në listëpagesat e shoqërisë si shofer, por që disponon lejen e drejtimit perkatese dhe mund të realizojë me sukses shërbimin e transportit të artikujve ushqimore, brenda afateve të ekzekutimit të kontratës.

Shenim: *Kriteri Nr.2.3.4 do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetedëklarimit shtojca 8. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori ekonomik kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Numri minimal prej 2 punonjësish, përkatësisht shofer/punëtor i thjeshtë, që operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion, është kërkuar duke u bazuar në numrin e automjeteve që janë kërkuar për kryerjen e transportit të mallrave objekt prokurimi sasisë së mallrave që do të transportohen dhe shpërndahen në destinacionin e kërkuar nga autoriteti kontraktor përfitues. Në lidhje me kërkesën që OE të disponojë 1 (një) person me profesionin shofer/punëtor i thjeshtë, OE paraqet 1 (një) punonjës që mund të jetë regjistruar në listëpagesat e shoqërisë si shofer ose punonjës i thjeshtë, por që disponon lejen përkatëse të drejtimit të mjetit dhe mund të realizojë me sukses shërbimin e transportit të mallrave objekt prokurimi brenda afateve të ekzekutimit të kontratës.*

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës duhet të vetëdeklarojë se, nga kontrolli i fundit i ushtruar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

Shenim: *Kriteri Nr 2.3.5 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e deklaratës. Dokumenti i kërkuar më sipër do të paraqitet në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

Argumentimi: *Në bazë të nenit 40, pika 6 dhe 8, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar dhe rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018. Nisur nga objekti i prokurimit, furnizime me ushqime, është e rëndësishme që operatorët ekonomikë të jenë të vlerësuar nga organet kompetente që e ushtrjnë aktivitetin e tyre konform legjislacionit të fushës, kjo për të rritur dhe garantuar sigurinë ushqimore dhe për të mbrojtur konsumatorin e fundit..*

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht 1 (një) stabiliment, në zbatim të nenit 19 të ligjit nr. 9863, date 28.01.2008 “Për ushqimin”.

Për të provuar këtë kriter duhet të paraqesë dokumentet:

- c) Çertifikatë pronësie ose kontratë noteriale qeraje/përdorimi të vlefshme, për stabilimentin.
- d) Licencën e kategorisë “II.1.A.1 për stabilimentin që ka paraqitur dokumentet sipas germës “a” të këtij kriteri.

Në rast të konstatimit të ushtrimit të stabilimentit jo në përputhje me këtë nen do të referohen pranë AKU për ndjekjen e procedurave përkatëse administrative sipas nenit 68 të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Per ushqimin”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenit 40, pika 8 e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar; Ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë; VKM nr.538, datë 26.05.2009 “Per licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nepermjet Qendres Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nenligjore të perbashketa” të ndryshuar; nenit 19 të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Per ushqimin” Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë ambjentet/stabilimentet dhe licencat përkatëse për keto stabilimente, për kryerjen e furnizimit objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Operatorët Ekonomikë duhet të zbatojnë kërkesat e Ligjit Nr.9863 datë 28.01.2008 “Për ushqimin” i ndryshuar, për furnizimin/shpërndarjen me produktet ushqimore në ambjentet e përcaktuara, si dhe për ruajtjen e higjienës dhe mjediset, kushteve tekniko-teknologjike dhe personelit. Dhënia e lejes përkatëse për fillimin e veprimtarisë së stabilimentit bëhet kur plotësohen kërkesat tekniko-teknologjike, higjiensanitare dhe veterinare për të garantuar sigurinë dhe cilësinë e ushqimeve, në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe të legjisllacionit në fuqi, për të mbrojtur shëndetin e konsumatorit. Qënësia e kësaj license garanton AK se operatori ekonomik lidhur me stabilimentin që disponon në njërin nga format e sipërcituara ka përbushur të gjithë parametrat e kërkuar dhe si rrjedhojë është pajisur me këtë lloj license për stabilimentin. Kërkesa për minimalisht 1(një) stabiliment është një kërkesë minimale që i krijon siguri autoritetit kontraktor se operatori ekonomik ka jo vetem pajisjet por edhe ambjentet e pershtatshme për realizimin me sukses dhe në vazhdimësi të kontratës objekt prokurimi.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të deklarojë sipas tabelës 1 nëse është **prodhues**. Nëse operatori ekonomik është **tregtues** duhet të deklarojë sipas tabelës 2, kontratat e furnizimit të lidhura me prodhuesin ose distributorin e autorizuar nga prodhuesi, për artikujt objekt prokurimi.

○ **Tabela 1.** Forma e deklaramit për operatorin ekonomik që paraqitet si prodhues i mallit.

Nr.	Emertimi i artikullit	Prodhues. Të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website
1		
2		
Etj...		

○ **Tabela 2.** Forma e deklaramit për operatorin ekonomik që paraqitet si tregtues i autorizuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi.

Nr.	Emertimi i artikullit	Prodhuesi/Distributori i autorizuar Të dhëna të plota si: telefon, fax, e-mail, website	Data e fillimit të kontratës së furnizimit	Data e përfundimit të kontratës së furnizimit
1				

2			
Etj...			

Shenim: Kriteri nr.2.3.7 konsiderohet i permbushur me plotesimin e vetëdeklarimit, sipas tabelës së mësipërme. Kontratat e furnizimit të kerkuara me siper do te paraqiten ne rast se operatori kualifikohet i pari, por perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit ose nese kerkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të nenit 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar autoriteti kontraktor ka të drejtë të kërkojë edhe dokumenta të tjera të cilat i konsideron të rëndësishme për objektin. Duke qënë se kemi të bëjmë me furnizime me ushqime, kërkohet siguri se operatori ekonomik ka mundësi te furnizojë në mënyrë të vazhdueshme dhe sipas kërkesës dhe afatit të caktuar nga autoriteti kontraktor, si në rastin kur është prodhues ashtu edhe në rastin kur nuk është prodhues i produktit. Duke qënë se kryesisht Autoritetet kontraktore përfituese janë spitale, qender pritje per të moshuar apo shtëpi foshnje edhe nevoja për ushqim është në çdo kohë domosdoshmëri, lind e nevojshme që të garantohet AK dhe të krijojë bindjen se furnizimi i ushqimit do të jetë i pandërprerë për të mos krijuar impakt tek konsumatori. Kontratat e furnizimit sigurojnë AK që tregtari ka një marrëveshje të qëndrueshme me prodhuesin, duke minimizuar rrezikun e ndërprerjeve në furnizim gjithashtu janë tregues edhe për një marrëdhënie të qëndrueshme me prodhuesin dhe ky fakt mund të ndihmojë në garantimin e cilësisë së produktit, pasi prodhuesi është i angazhuar për të përmbushur standardet e kerkuara.

2.3.8 Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë në procedurën e prokurimit publik çertifikatën **SSH EN ISO 22000:2018** ose ekuivalente për sistemin e menaxhimit të sigurisë ushqimore për prodhimin dhe tregtimin e produkteve ushqimore me origjinë shtazore dhe jo shtazore, të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në Rekomandim Nr. 10181 Prot, datë 19.11.2018, “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore” të hartuar nga Agjencia e Prokurimit Publik në bashkëpunim me Autoritetin Kombëtar të Ushqimit. Kriteri për Certifikatë të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë SSH EN ISO 22000:2018, është vendosur në bazë të nenit 79 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 44, të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion certifikimet e duhura për mallrat objekt prokurimi.

3-Standarti ISO 22000 specifikon, kërkesat e përgjithshme për zhvillimin, zbatimin dhe përmirësimin e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore të një kompanie. ISO 22000 u drejtohet të gjitha kompanive që marrin pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në zinxhirin e furnizimit ushqimor dhe mund të zbatohet nga të gjitha kompanitë, pavarësisht nga madhësia apo kompleksiteti i tyre.

ISO 22000 është standardi më i lartë i certifikimit të Sistemeve të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore. Parimet themelore të standardit janë:

5. *Kontroll efektiv në të gjithë zinxhirin e furnizimit ushqimor*
6. *Komunikim efektiv midis të gjitha palëve të interesuara të zinxhirit të furnizimit ushqimor (biznese, furnitorë, klientë, autoritete)*
7. *Menaxhim sistematik*
8. *Programet e nevojshme*
9. *Parimet e analizës së rrezikut dhe pikat kritike të kontrollit (HACCP)*

Standardi bazohet gjithashtu në parimet që janë të përbashkëta me standardet e sistemit të menaxhimit. Parimet e menaxhimit janë:

- *Fokus ndaj klientit*
- *Angazhimi i menaxhimit të lartë*
- *Pjesëmarrje aktive e personelit*
- *Qasje ndaj procesit*
- *Përmirësim i vazhdueshëm*
- *Vendimmarrje e bazuar në dokumentacion*
- *Menaxhim i marrëdhënieve me palët e interesuara*

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

***Shënim:** Operatori ekonomik i cili oferton në më shumë se sa një Lot, duhet të ketë/disponojë kapacitetin ekonomik – financiar (pika 2.2.1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetin teknik pika 2.3.1 e seksionit 2.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku.*

Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotësohet për kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike sipas përcaktimit më sipër për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të s'kualifikohet nga të gjitha Lotet ku ka ofertuar.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike :

*Specifikimet teknike ndodhen bashkëlidhur dokumentave standarte të tenderit dhe janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grupe pune pranë Autoriteteve Kontraktore përfituese për objektin që prokurohet, të ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencave, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si edhe në përputhje me katalogun/standartin e miratuar të specifikimeve teknike për “Blerje artikuj ushqimorë” nga ish Agjensia Shtetërore e Blerjeve të Përqëndruara **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Referuar sa më sipër përgjegjësia për hartimin e specifikimeve teknike është e strukturave të specializuara/ Grupeve të punës pranë Autoriteteve Kontraktore përfituese ndërsa hartimi i kërkesave për kualifikim dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialistët anëtarë të njësive së prokurimit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit Njësia e Prokurimit

autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

Bashkëlidhur këtij procesverbali:

- *Dokumentat e tenderit*
- *Specifikimet teknike*

NJËSIA E PROKURIMIT